**FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:**
**Informacion për përdoruesin**

# ADRENALINE

Tretësirë për injeksion – 1 mg / ml (0.1%)
*(Adrenalinë hidrogjentartrat)*

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.**

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet, ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në këtë fletëudhëzues:**


1. Çfarë është Adrenaline dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Adrenaline
3. Si ta merrni Adrenaline
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Adrenaline
6. Informacion i mëtejshëm


## 1. ÇFARË ËSHTË ADRENALINE DHE PËRSE PËRDORET

Adrenalina është një substancë endogjene e organizmit, e prodhuar në palcën e gjendrës mbiveshkore, e cila ka efekte farmakologjike të rëndësishme. Ajo është një agonist i fuqishëm i adrenoreceptorëve alfa dhe beta, megjithëse efekti tek beta-receptorët është më i shprehur, kryesisht në doza të vogla.

Efektet kryesore të adrenalinës janë të lidhura me dozën dhe përfshijnë:
zgjerimin e bronkeve, ngushtimin e enëve të gjakut, rritjen e frekuencës dhe të forcës tkurrëse të zemrës (efekti kronotrop dhe inotrop pozitiv) dhe stimulimin në nivel qendror. Adrenalina është antagoniste e histaminës. Ajo përdoret për trajtimin e emergjencave për jetën.

Adrenaline përdoret në reaksionet akute alergjike dhe në shok anafilaktik.
Gjithashtu përdoret në problemet kardiake kërcënuese për jetën. Mjeku juaj mund t'ju ketë dhënë Adrenaline për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun nëse doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

## 2. PËRPARA SE TË MERRNI ADRENALINE

**Mos merrni Adrenaline në qoftë se:**

- jeni alergjik ndaj saj ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të tretësirës;
- vuani nga arterioskleroza cerebrale ose dëmtimi organik i trurit;
- vuani nga kardiomiopatia, pamjaftueshmëria koronare, hipertensioni;
- vuani nga glaukoma me kënd të ngushtë;
- vuani nga diabeti;
- vuani nga feokromocitoma apo nga hipertiroidizmi;
- i nënshtroheni një anestezie të përgjithshme me hidrokarbure të halogjenuara ose ciklopropan;
- jeni shtatzënë;
- keni kolaps cirkulator të shkaktuar nga fenotiazinat;
- mjekoheni me frenues të monoaminëoksidazës (MAO-I);
- keni pësuar shok anafilaktik gjatë anestezisë së përgjithshme me hidrokarbure të halogjenuara ose ciklopropan.

Kundërindikohet administrimi i adrenalinës në ekstremitete (gishtat e duarve dhe të këmbëve, hundë, organet genitale, etj.).
Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, para përdorimit flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

**Tregoni kujdes të veçantë me Adrenaline**

- Adrenalina duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me çrregullimekardiovaskulare, sepse ata mund të jenë më të ndjeshëm ndaj efekteve të saj. Kujdes i veçantë duhet treguar tek pacientët me aritmi kardiake, sëmundje iskemike të zemrës ose hipertension.
- Tregoni kujdes të veçantë nëse keni ose keni patur ndonjë problem shëndetësor, në veçanti të mëposhtmit:
- Çrregullime kardiovaskulare, edemë pulmonare, hipertension, hipertiroidizëm, diabet, sëmundje psikoneurotike, astmë, hemorragji cerebrale.
- Adrenalina duhet përdorur me shumë kujdes tek të moshuarit dhe tek fëmijët.
- Adrenalina nuk duhet përdorur bashkë me barna të tjera, sepse ato mund të ndikojnë në veprimin e saj.
- Ky bar përmban metabisulfit natriumi, i cili mund të shkaktojë reaksione alergjike (edhe shok anafilaktik) tek personat e ndjeshëm. Personat më të ndjeshëm ndaj sulfiteve janë të sëmurët astmatikë.

**Marrja e barnave të tjera**
Ndërveprimet me adrenalinën janë komplekse dhe mund të jenë të dëmshme.

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, përfshirë edhe ato të marra pa recetë.
Kjo ka rëndësi të veçantë në qoftë se jeni duke marrë ndonjë prej barnave të mëposhtëm:

- anestezikë të gaztë, veçanërisht ciklopropan ose halotan, sepse mund të ndodhin aritmi të rrezikshme;
- levotiroksinë (hormon sintetik i tiroides) ose antihistaminikë, sepse fuqizojnë veprimin e adrenalinës;
- barna që ndikojnë në përçimin kardiak, si glikozidet kardiake dhe antiaritmikët;
- frenues të MAO-s (MAO – I), sepse mund të fuqizojnë efektet e adrenalinës;
- antidepresivë triciklikë, sepse bllokon inaktivizimin e adrenalinës duke e kapur atë në mbaresat nervore dhe mund të fuqizojë efektet e saj duke shkaktuar hipertension dhe aritmi;
- vazodilatatorë me veprim të shpejtë ose alfa – bllokues, sepse këto barna mund të neutralizojnë efektin hipertensiv të adrenalinës;
- beta-bllokues, kryesisht ata joselektivë, sepse administrimi i njëkohshëm me adrenalinën mund të rezultojë me hipertension të rëndë;
- klonidinë, sepse ekziston rreziku për hipertension;
- entakapon, sepse mund të fuqizojë efektet e adrenalinës;
- dopeksaminë, sepse mund të fuqizojë efektet e adrenalinës;
- ergotaminë dhe metisergid;
- oksitocinë.

**Shtatzënia**
Kategoria C.
Adrenalina e kalon placentën.
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni një shtatzëni.
Adrenalina kundërindikohet në shtatzëni sepse ajo mund të kufizojë furnizimin me gjak të placentës, të shkaktojë takikardi, çrregullime kardiake, ekstrasistola tek fetusi dhe mund të vonojë fazën e dytë të lindjes.

**Ushqyerja me gji**
Adrenalina kalon në qumështin e gjirit.
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri!
Mjeku ose farmacisti do t'ju këshillojë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së saj gjatë kësaj periudhe.

**Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive**
Tregoni kujdes nëse drejtoni automjetin apo përdorni makineri.

**Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Adrenaline**
Ky bar përmban metabisulfit natriumi, i cili rrallë mund të shkaktojë reaksione të rënda mbindjeshmërie dhe bronkospazëm.

## 3. SI TA MERRNI ADRENALINE

*Adrenaline është një bar me potencial të rrezikshëm që përdoret në trajtimin e situatave ku rrezikohet jeta dhe duhet të përdoret me këshillën e mjekut.*
*Administrimi i saj duhet bërë vetëm nga personel i specializuar.*

**Është e rëndësishme të theksohet** se zakonisht adrenalina injektohet intramuskul, megjithëse mund të injektohet edhe nën lëkurë.

Në emergjenca ekstreme, ku kërkohet një efekt më i shpejtë, adrenalina mund të administrohet **si tretësirë e holluar** (1:10 000 ose 1:100 000) me injeksion shumë të ngadalshëm intravenoz ose me perfuzion të ngadalshëm intravenoz. Injektimi intravenoz mund të bëhet në një venë qendrore ose periferike. Nëse administrohet në venë periferike, duhet të shoqërohet me të paktën 20 ml fluid intravenoz.

***Në shok anafilaktik:*** *doza e zakonshme* është 0.5 mg (0.5 ml të tretësirës me hollim 1:1000 (0.1%)) intramuskul, e cila mund të përsëritet sipas nevojës çdo 5 minuta.

*Doza për fëmijë* varet nga mosha dhe pesha, por zakonisht është rreth 0.01 mg/kg *intramuskul.*

***Në arrest kardiak:*** doza për të rritur është 1 mg intravenoz (10 ml të tretësirës me hollim 1:10 000), e cila mund të përsëritet çdo 2 – 3 minuta gjatë proçedurës së reanimimit.

*Doza për fëmijë* është 0.01 mg/kg intravenoz.

**Administrimi në venë duhet bërë si tretësirë e holluar (1:10 000) dhe në mënyrë të ngadaltë.**

***Në status asthmaticus:*** nëse vendoset të përdoret adrenalinë, *doza për të rritur* është 0.3 – 0.5 mg (0.3 – 0.5 ml të tretësirës me hollim 1:1000) nën lëkurë ose intramuskul.

*Doza për fëmijë* është 0.01 ml/kg (0.01 mg/kg).

Në qoftë se ndjeni që efektet e adrenalinës janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në qoftë se keni marrë më shumë Adrenaline**
Duke qenë se ky bar do ju administrohet në spital, nuk ka shumë gjasa të merrni dozë shumë më të lartë apo më të ulët në krahasim me dozën e duhur, megjithatë, njoftoni mjekun ose infermierin nëse keni ndonjë shqetësim.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, të shumtën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson:

Efektet anësore janë të renditura më poshtë sipas shpeshtësisë:
**Shumë të zakonshme:** mund të prekin më shumë se 1 në 10 pacientë.
**Të zakonshme:** mund të prekin 1 deri në 10 nga 100 pacientë.
**Jo të zakonshme:** mund të prekin 1 deri në 10 nga 1,000 pacientë.
**Të rralla:** mund të prekin 1 deri në 10 nga 10,000 pacientë.
**Shumë të rralla:** mund të prekin më pak se 1 në 10,000 pacientë.
**Të panjohura:** shpeshtësia nuk mund të vlerësohet nga të dhënat e disponueshme

<u>Të rralla ose shumë të rralla</u>

- kardiomiopati

<u>Të panjohura</u>

- *kardiovaskulare:* aritmi kardiake, palpitacione, hipertension i theksuar (sidomos në të sëmurët hipertiroidikë dhe hipertensivë), dhimbje anginoze në të sëmurët e predispozuar, hemorragji cerebrale dhe subaraknoidale;
- *në sistemin nervor qendror:* ankth, dhimbje koke, shqetësim, dridhje, dobësi, hemiplegji, marrje mendsh dhe pagjumësi;
- të përziera, të vjella, vështirësi në frymëmarrje, acidozë e rëndë metabolike, hipokalemi, zverdhje, ftohje e ekstremiteteve, urtikarie, djersitje, shtim i prodhimit të pështymës, tharje goje, pakësim i oreksit;
- flluska dhe hemorragji në vendin e injektimit;
- nekrozë në vendin e injektimit kur bëhen disa injektime;
- rritje e përkohshme e glukozës në gjak;
- rritje e acidit laktik në serum.

Mbidozimi mund të shkaktojë aritmi kardiake dhe rritje të shpejtë të presionit të gjakut (duke shkaktuar ndonjëherë hemorragji cerebrale dhe edemë pulmonare); këto efekte mund të shfaqen edhe në doza normale tek subjektet e ndjeshëm.

Dalja jashtë vene e adrenalinës së administruar në rrugë parenterale, me të njëjtën mënyrë shkakton ngushtim të theksuar të enëve të gjakut, duke rezultuar në nekrozë dhe shkatërrim të indit.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 5. SI TA RUANI ADRENALINE

Ruajini ampulat nën 25°C.
Mbrojini nga drita.
Mbajini në kutinë përkatëse dhe mos i përdorni pas datës së skadencës të shënuar në të.
Mbajeni këtë bar larg fëmijëve!

## 6. INFORMACION I MËTEJSHËM

**Çfarë përmban Adrenaline**
**Lënda aktive** është Adrenalinë hidrogjentartrat.
Çdo ampulë 1 ml përmban 1 mg adrenalinë (si hidrogjentartrat).
Përbërësit e tjerë janë: metabisulfit natriumi, klorur natriumi, acid klorhidrik mund të shtohet për rregullim pH, ujë për injeksion.

**Përmbajtja e paketimit**
Kuti kartoni me 10 ampula nga 1 ml.

**Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:**


**PROFARMA** sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602


**Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Dhjetor 2023**

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

**PAY ATENTION**, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.